267
14.02.2020

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

**Nr.**701**/Prot** **Elbasan më** 18/02/**2020**

**VENDIM**

**Nr.13 date 11/02/2020**

**"Per miratimin ne parim te Rregullores se Keshillit Bashkiak Elbasan"**

Keshilli Bashkiak Elbasan ne mbledhjen e tij te dates 11.02.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Komisioni per Çeshtje Ligjore per projekt-rregulloren e organizimit dhe funksionimit te Keshillit Bashkiak, bazuar ne ligjin 139/2015, "Per Veteqeverisjen Vendore" nenet 8,9,54 te tij,

**VENDOSI:**

1. Te miratoj ne parim Rregulloren per Organizimin dhe Funksionimin e Keshillit Bashkiak Elbasan, sipas teksit bashkangjitur ketij vendimi.
2. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Klajd GRIPSHI**

**KRYETARI**
**Hektor ÇIFTJA**

268
14.02.2020

(9)

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Nr. 477 Prot.** **Elbasan, më 18.02.2020**

**VENDIM**

**Nr. 14 datë 11.02.2020**

***"Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2020"***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës ___.02.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan *"Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2020"*, mbështetur në:

a) Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar);
b) Ligjin nr.79/2017 "Për sportin";
c) Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ekipet sportive dhe trajnerët përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2020, si më poshtë:

| *Nr.* | *Disiplinat Sportive / Ekipet* | *Trajneri* |
|---|---|---|
| | **VOLEJBOLL** | |
| 1 | Të Rritur | Fisnik Lushjani |
| 2 | Të Rinj | Klajdi Kallajxhiu |
| 3 | Të Rritura | Rudina Garunja |
| 4 | Të Reja | Esmeralda Garunja |
| | **BASKETBOLL** | |
| 5 | Të Rritur | Banush Sinani |
| 6 | Të Rinj | Geri Biçoku |

| | | |
|---|---|---|
| 7 | Të Rritura | Elvira Xhyra |
| 8 | Të Rritura / Të Reja | Alqi Çabiri |
| | **HENDBOLL** | |
| 9 | Të Rritur | Fabio Lufta |
| | **PESHËNGRITJE** | |
| 10 | Të Rritur | Ilir Çelaj (vullnetar) |
| 11 | Të Rinj | Endri Karina |
| 12 | Të Rritura / Të Reja | Eglantina Çuni |
| | **KARATE** | |
| 13 | Të Rritur | Sokol Pisha |
| 14 | Të Rinj | Gëzim Kllogjeri |
| 15 | Të Rritura / Të Reja | Judis Hoxha |
| | **ALPINIZËM** | |
| 16 | Të Rritur (M & F) | Artur Guni |
| | **ÇIKLIZËM** | |
| 17 | Të Rritur | Abaz Kovaçaj |
| | **PING - PONG** | |
| 18 | Meshkuj | Gëzim Tosuni |
| 19 | Femra | Greta Kovaçi |
| | **ATLETIKË** | |
| 20 | Të Rritur | Hamit Demiri |
| 21 | Të Rinj | Fatos Uruçi |
| 22 | Të Rritura / Të Reja | Zhani Ruçaj |
| | **QITJE** | |
| 23 | Meshkuj | Klevis Hida |
| 24 | Femra | Bardhyl Myftaraj |
| | **SNOOKER** | |

| | | |
|---|---|---|
| 25 | Të Rritur | Erald Sejdini |
| | **TAEKWONDO** | |
| 26 | Meshkuj & Femra | Ligor Shaka |
| | **JUDO** | |
| 27 | Meshkuj | Ana Beqiraj |
| | **RADIOAMATORIZËM** | |
| 28 | Meshkuj & Femra | Drini Dervishi |
| | **BOKS** | |
| 29 | Meshkuj | Altin Kaçi |

2. Ngarkohen Klubi Shumësportesh, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Financës në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**
**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**
**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

269
14.02.2020

3

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA ELBASAN**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.700/1 Prot. **Elbasan, më 18.02.2020**

# V E N D I M

**Nr. 15 Datë: 11.02.2020**

***"Mbi dhënie me qira të objektit "Albania Tourism" ndodhur në Z.K. 8521""***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.02.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) dhe propozimin e Këshillit Bashkiak, bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 *"Për miratimin e listës përfundimtare të Pronave të Paluajtëshme të Shtetit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan";* ligjin Nr. 107/2014 *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit";* V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 *"Për përcaktimin e kritereve, të proçedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar;* Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 24 datë 24.02.2009 *"Mbi miratimin e tarifave të dhënies së ambjenteve me qira nga Bashkia Elbasan";*

## V E N D O S I :

1. Miraton dhënien me qera të objektit "Albania Tourism" pozicionuar mbi pasurinë nr. 1/46 e transferuar në pronësi të Bashkisë Elbasan, ndodhur në Lagjen "Luigj Gurakuqi", Z.K. 8521 me sipërfaqe 37.21 m$^2$, për t'u përdorur për "Promovim të vlerave kulturore të qytetit, shërbim dhe informacion turistik, etj.", me tarifë qeraje mujore 200 (dyqind) lekë/m$^2$, subjektit "Person Juridik", Sh.p.k. me Nipt: M02530201R, me afat 5 (pesë) vjet nga data 01.02.2020 deri më 31.01.2025.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

**SEKRETARI**
**Klajd Gripshi**

**KRYETARI**
**Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 698/1 Prot.

Elbasan, më 18.02.2020

# V E N D I M

Nr. 16 Datë: 11.02.2020

***"Mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë nr. 2696/1 prot datë 06.07.2018"***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.02.2020 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave) bazuar në ligjin Nr.139/2015 *"Për Vetëqeverisjen Vendore"*, Ligjin Nr. 7850 datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë"*, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 88 datë 21.06.2018 *"Mbi dhënie me qira të objektit "Albania Tourism" ndodhur në Z.K. 8521""*

## V E N D O S I :

1. Miraton zgjidhjen e kontrtës së qirasë me nr. 2696/1 prot., datë 06.07.2018 për objektin "Albania Tourism" midis subjektit "Erion Kondaj" dhe Bashkisë Elbasan.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Përgjithshme e Planifikimit të të Ardhurave Aseteve Buxhetit dhe Financës, (sektori i pronave), Drejtoria Buxhetit dhe Drejtoria Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Hektor Çiftja

3/2 (3)

271
14.02.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 714/1 Prot.    Elbasan më, 18 .02.2020

VENDIM

Nr. 17 Date: 11 .02.2020

**"Mbi dhënie me qira (rinovim kontratash) të disa ambjenteve nga Bashkia Elbasan"**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___.02.2020, pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh Elbasan, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, VKM nr.416, datë 11.07.2007 " Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajteshme të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkise Elbasan",VKM nr.54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira , enfiteoze apo kontrata të tjera, të pasurive shtetërore ", i ndryshuar, VKB nr.24, datë 24.02.2009 " Mbi miratimin e tarifave të dhënies së ambjenteve me qira nga Bashkia Elbasan " dhe VKB nr.33, date 27.04.2010 "Mbi miratimin për dhënien me qira të ambjenteve në godinën e Sport Klub Elbasani" ;

**V E N D O S I:**

**1.** Të miratojë dhënien me qira të ambjentit "dhomë" në godinën e Pallatit të Sportit, kati i parë, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 56.7 $m^2$, me tarifë mujore qiraje 600 lekë/$m^2$, siç ka qenë në kontratën e mëparshme, me afat 1-vjeçar nga 01.01.2020 deri 31.12.2020, Zj.Vetiana Gica.

**2.** Të miratojë dhënien me qira të ambjentit "dhomë" në godinën e Pallatit të Sportit, kati i parë, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 32.4 $m^2$, me tarifë mujore qiraje 200 lekë/$m^2$, siç ka qenë në kontratën e mëparshme, me afat 1-vjeçar nga 01.01.2020 deri 31.12.2020, Zj.Vetiana Gica.

**3.** Te miratoje dhënien me qira të një ambjenti dhomë ( riparime elektrike e elektronike), kati i parë, ana jugore e godinës, me sipërfaqe 19 $m^2$, me tarifë qiraje mujore 150 lekë/$m^2$, si në kontratën e mëparshme, për periudhë 1- vjeçare nga 01.01.2020 deri 31.12.2020, Z. Jorgji Biqiku. Gjithashtu qiramarrësi do t'i ofrojë Klubit Shumësportesh Elbasan shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit elektronik të lojrave, pa pagesë.

**5.** Të miratojë dhënien me qira të një ambjentin bar – kafe, kati i parë, ana jug-lindore e godinës, me sipërfaqe 34.41 $m^2$, me tarifë qiraje mujore 600 lekë/$m^2$, si në kontratën e mëparshme, për periudhë 1-vjeçare nga 01.01.2020 deri 31.12.2020, Z. Mario Kociaj.

**4.** Të miratojë dhënien me qira të një ambjenti "Holl pasagjeresh", kati përdhes, me sipërfaqe 20 $m^2$, me tarifë 250 lekë/$m^2$, për një periudhë 1- vjeçare nga 01.01.2020 deri 31.12.2020, shoqërisë "Era Travel".

**7.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Klubi Shumësportesh Elbasan dhe Drejtoria Përgjthshme e Planifikimit të Ardhurave, Aseteve, Buxhetit dhe Financës.

**8.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

| | |
|---|---|
| **SEKRETARI** | **KRYETARI** |
| **Klajd GRIPSHI** | **Hektor Çiftja** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

272
14.02.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 699/1 prot. Elbasan më 18/02/2020

# VENDIM

## Nr. 18 datë 11/02/2020

## " Mbi bashkimin e ndërmarrjes së terreneve sportive me klubin shumësportësh Elbasan dhe rishikimin e numrit të punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve Publike".

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës......../....../2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore për bashkimin e ndërmarrjes së terreneve sportive me klubin shumësportësh Elbasan dhe rishikimin e numrit të punonjësve të këtij klubi dhe të Agjensisë së Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet 8,9,54 të tij, ligjin 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", neni 40;

## VENDOSI :

1- Ndërmarrja e Terreneve Sportive i bashkohet Klubit Shumësportësh Elbasan, duke pushuar së funksionuari si njësi buxhetore më vete.
2- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Klubit Shumësportësh Elbasan të jetë 41.
3- 11 punonjësit që do transferohen nga klubi shumësportësh do i kalojnë Agjensisë së Shërbimeve Publike.
4- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Agjensisë së Shërbimeve publike shkon në 248.
5- Administrata e Bashkisë dhe ajo e njësive që bashkohen, të marrin masat për transferimin e inventarit dhe aseteve që zotërojnë, nga ndërmarrja e terreneve sportive në Klubin shumësportësh Elbasan.
6- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Kryetari i Bashkisë , Drejtoria Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Buxhetit, Klubi Shumësportësh, Ndërmarrja e terreneve sportive dhe Agjensia e Shërbimeve Publike.
7- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI** | **KRYETAR**

**Klajd GRIPSHI** | **Hektor Çiftja**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

273

14.02.2020

5 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA ELBASAN

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 769/1 Prot. Elbasan, më 18.02.2020

**VENDIM**

**Nr. 19 date 11.02.2020**

***"Mbi miratimin e Bordit Artistik pranë Qendrës së Artit, Bashkia Elbasan"***

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e datës ___.02.2020, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Elbasan, bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar) dhe në ligjin nr.10352 datë 18.11.2011 "Për artin dhe kulturën" (i ndryshuar) kreu IV, neni 28 (pika 3):

**VENDOSI**

1. Të miratojë Bordin Artistik pranë Qendrës së Artit, Bashkia Elbasan, si mëposhtë vijon:

- ***Kliton Kapaj*** - *Drejtor i Qendrës së Artit* - *kryetar;*
- ***Fatmir Musaj*** - *Drejtor i Drejtorisë së TKRS* - *anëtar;*
- ***Klinsi Lala*** - *Regjizor* - *anëtar;*
- ***Astrit Lopari*** - *Muzikolog* - *anëtar;*
- ***Mehdi Zena*** - *Këngëtar* - *anëtar;*
- ***Enea Jorgji*** - *Arbitër* - *anëtar;*
- ***Fatbardha Topuzi*** - *Specialiste muzike* - *anëtare;*

2. Anëtarët e Bordit Artistik kanë mandat 4-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

3. Anëtarët e Bordit Artistik do të paguhen me një shpërblim prej 4.500 lekësh, për çdo mbledhje që do të zhvillohet, shpenzim ky që do të përballohet nga fondi i buxhetit të Bashkisë Elbasan për projektet kulturore.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Turizmit dhe

Sporteve, Qendra e Artit dhe Drejtoria e Buxhetit në Bashkinë Elbasan.

5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

| | |
|---|---|
| **SEKRETARI** | **KRYETARI** |
| **Klajd Gripshi** | **Hektor Çiftja** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN